

GUIDË
MBI
TË DREJTËN
E AZILIT





Ky projekt zhvillohet në kuadër të programit “Sfidat e krizës së refugjatëve dhe kërkesat e integritit evropian”. Qëllimi i projektit është prezantimi në terma të thjeshtë i rregullave të vendosura nga e drejta ndërkombëtare mbi azilin për të ndihmuar fokus-grupe të ndryshme. Ky botim u realizua nga Qendra Europiane, me mbështetjen e çmuar të Fondacionit Konrad Adenauer Shqipëri, i cili financoi projektin.

Për të dhëna të mëtejshme në lidhje me të drejtën e azilit mund të drejtoheni tek:

Qendra Europiane

Rr. Vaso Pasha
P. 20, Ap. 57
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 4 451 9076
www.euro-centre.eu

Fondacioni Konrad Adenauer

Blv. Dëshmorët e Kombit
Kulla Binjake 1, K. 11, Ap. 3
Tiranë, Shqipëri
Tel: + 355 4 22 66525
www.kas.de/albanien

Botues:

ISBN:

Desing & Layout: Dritan Lleshi

SHKURTIME

BE	Bashkimi Evropian
CEAS	Sistemi i Përbashkët i Azilit në Bashkimin Evropian
EURODAC	Databaza e të dhënave për regjistrimin e gjurmëve të gishtave për çështjet e azilit në BE
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
UNCHR	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët



I. NË VEND TË HYRJES

Qysh prej fillimit të Pranverës Arabe dhe veçanërisht krizës në Siri, gjendja lidhur me emigrantët dhe refugjatët në kërkim të një jetë më të sigurtë jashtë vendeve të tyre është përkeqësuar së tepërmi. Me miliona njerëz tashmë kanë kërkuar azil, në veçanti në Shtetet Anëtare të Bashkimit European ku si portë hyrëse kanë shërbyer kryesisht vendet e Mesdheut.

Sipas të dhënave të UNHCR-së gjatë vitit 2016 numri i azilkërkuesve, që kanë mbërritur në Evropë nga deti është 161,900, prej të cilëve 147,437 kanë hyrë në Greqi. Ndërkohë, 45% e këtyre azilkërkuesve kanë origjinë siriane, 24% afganë, 15% iranianë dhe pjesa tjetër nga vende të ndryshme.

Pesë vendet e BE-së me numrin më të lartë të kërkesave janë: Gjermania, Franca, Suedia, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar. Së fundmi, ka pasur një fluks masiv të azilkërkuesve të cilët kanë përdorur si një urë kalimi tranzit vendet e Ballkanit Perëndimor drejt BE-së, apo dhe raste të tilla ku ata kanë qëndruar në këto vende duke kërkuar azil.

Për më tepër, gjatë viteve 2014 dhe 2015 mijëra qytetarë të Ballkanit Perëndimor u larguan për të kërkuar azil në vendet BE-së, veçanërisht në Gjermani, me arsyetimin e gjendjes së mjeruar ekonomike. Kjo situatë po kërcënon të drejtën ndërkombëtare të refugjatëve, Sistemin e Përbashkët Evropian për Azilin, standardet e kërkuara nga KEDNJ dhe legjislacionet kombëtare të refugjatëve të disa vendeve. Në një kontekst më të gjerë rrezikohet së tepërmi rritja e ndjenjave të ksenofobisë dhe racizmit në të gjithë Evropën.



© UNCHR/Massimo Sestini

Gjendja aktuale për çështjet e azilit në Evropë kërkon vëmendjen dhe trajtimin në mënyrën e duhur për zgjidhjen e kësaj situate, ku përveç të tjerave kërkohet bashkëpunimi dhe shprehja e vullnetit të mirë të gjithë vendeve të kontinentit të vjetër.

Në kuadër të kësaj problematike është mjaft e domosdoshme dhe e nevojshme përmirësimi i njohurive lidhur me standardet e së drejtës ndërkombëtare për të drejtën e azilit, të cilat janë thelbësore për të pasur një adresim të saktë të situatës si dhe mirëfunksionimin e sistemeve legjislative dhe gjyqësore në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor.

II. NOCIONET BAZË

Mbrojtja ndërkombëtare mund të përkufizohet si “të gjitha veprimet, të cilat kanë për qëllim të sigurojnë akses dhe gëzim të barabartë të të drejtave të grave, burrave, vajzave dhe djemve të mbrojtur nga Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), në përputhje me legjislacionin në fuqi (duke përfshirë këtu legjislacionin ndërkombëtar për mbrojtjen humanitare, të drejtat e njeriut dhe të refugjatëve).

Kjo mbrojtje përfshin ndërhyrjet nga Shtetet ose UNHCR në emër të azilkërkuesve dhe refugjatëve për të garantuar të drejtat, sigurinë dhe mirëqenien e tyre, të cilat njihen dhe garantohen në përputhje me standardet ndërkombëtare. Ndërhyrje të tilla përfshijnë: respektimin e parimit të *non-refoulement*¹, parimin e sigurisë, të drejtën për një proces të rregullt për përfitimin e statusit të refugjatit, respektimin e standardeve të trajtimit njerëzor dhe zbatimi i zgjidhjeve afatgjata.

Azilkërkues është një person, i cili kalon kufijtë ndërkombëtarë për shkak të frikës nga persekutimi. Përkufizohet kështu, për sa kohë që nuk ka marrë ende përgjigje apo vendimin mbi kërkesën e tij për të përfituar statusin e refugjatit. Derisa kërkesa të shqyrtohet, azilkërkuesi ka të drejtë të mos kthehet në vendin e origjinës. Sapo merr statusin e refugjatit apo ndonjë status tjetër p.sh. mbrojtje humanitare, azilkërkuesi quhet refugjat apo person që ka përfituar azil.

¹ Shih nenin 34 të Konventës së Gjenevës 1951.

Migrimi i detyruar është zhvendosja jo e vullnetshme e një personi me qëllim që t`i shpëtojë një konflikti të armatosur, një situatë dhune, shkeljes të të drejtave të tij/saj, një katastrofë natyrore, ose një katastrofë të shkaktuar nga njerëzit. Ky term përdoret për zhvendosjet e refugjatëve dhe zhvendosjet e detyruara të popullsisë ndërmjet shteteve.

Hyrja në mënyrë të paligjshme nënkupton kalimin e kufijve pa përmbushur kushtet e domosdoshme për të hyrë në mënyrë të ligjshme në territorin e një shteti.

Dëbim është akti përmes të cilit një shtet largon një shtetas të huaj, që ndodhet brenda territorit të atij shteti, pas refuzimit të pranimit ose ndërprerjes së lejes për të qëndruar.

Deportimi është akti përmes të cilit një shtet largon një shtetas të huaj, që ndodhet brenda territorit të atij shteti, pas refuzimit të pranimit ose ndërprerjes së lejes për të qëndruar. Ndërsa kthimi i migrantëve mund të jetë spontan apo i asistuar (dhe për këtë arsye përfshin një element të rëndësishëm siç është vullneti), deportimi është ekzekutimi i menjëhershëm i largimit.

Urdhri i dëbimit është akti që ndalon qëndrimin në territorin e një shteti. Urdhëri jepet në rastet kur individit ka hyrë në mënyrë ilegale ose nuk është i autorizuar të qëndrojë më në territorin e atij shteti.

Ri-atdhesimi është një nën-kategori e migrantëve të kthyer dhe i referohet refugjatëve që kthehen në vendet e tyre të origjinës, të burgosurve të luftës sipas Konventës së Gjenevës të vitit 1949, civilëve në kohë lufte dhe diplomatëve në kohë krize, sipas Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike dhe Konsullore, respektivisht të vitit 1961 dhe 1963.

Vend i sigurt origjine përdoret për të përcaktuar vendet të cilat prezumohen se janë të sigurta për të jetuar bazuar në sistemin demokratik të qëndrueshëm, si edhe zbatojnë traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Shtetësia dhe Pashtetësia. Për t`u konsideruar shtetas në bazë të ligjit do të thotë që:

- » një individ duhet të plotësojë kushtete parashikuara për shtetësinë në legjislacionin e një shteti, ose;
- » individit i është dhënë shtetësia përmes një vendimi të marrë nga autoritetet kompetente.

Shumica e njerëzve konsiderohen shtetas në kuadër të ligjeve të shtetit ku personi ka lindur (*jus soli*), ose ligjeve të shtetit nga i cili kanë shtetësinë prindërit e personit të lindur (*jus sanguinis*).

Në bazë të Konventës së New York-ut të vitit 1954 dhe të drejtës zakonore ndërkombëtare një person pa shtetësi është dikush, i cili nuk konsiderohet shtetas nga legjislacioni në fuqi i asnjë shteti. Marrja në shqyrtim e rasteve të individëve pa shtetësi është një ndër detyrat kryesore të UNHCR-së.

Ri-strehimi është transferimi i refugjatëve nga vendi ku ata kanë kërkuar azil në një shtet tjetër që ka rënë dakord për t'i pranuar ata si refugjatë duke ju dhënë zgjidhje të përhershme siç është marrja e shtetësisë së atij shteti. UNHCR-së i është dhënë mandati, që të mund të sigurojë si zgjidhje të qëndrueshme ri-strehimin, kjo edhe përmes bashkëpunimit me shtetet anëtare. Ri-strehimi nuk është një e drejtë dhe shtetet nuk kanë asnjë detyrim për të pranuar refugjatët nëpërmjet këtij procesi.



Dokumenti përfundimtar i Konventës së Gjenevës 1951. © UNCHR

III. KUADRI LIGJOR


Dokumenti ndërkombëtar kryesor, që garanton të drejtat e refugjatëve është Konventa e Gjenevës e vitit 1951 dhe Protokollin e vitit 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatit.

Gjithashtu, të drejtat e refugjatit garantojnë edhe nga:

- » Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriutⁱ;
- » Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropianⁱⁱ;
- » Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropianⁱⁱⁱ.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut nuk përmban asnjë nen, që garanton në mënyrë specifike të drejtat e azilkërkuarit ose refugjatit. Megjithatë, rikthimi i një individit nga pikat kufitare ose nga çdo vend tjetër, i cili gjendet brenda juridiksionit të një shteti dhe për rrjedhojë vendosja e këtij individit në rrezik potencial për t'iu nënshtruar torturës ose trajtimit a ndëshkimit çnjerëzor ose degradues ndalohej nga neni 3 i Konventës. Në raste ekstreme rikthimi, ekstradimi ose përjashtimi mund të ngrejë edhe një çështje në kuadër të nenit 2 KEDNJ, i cili garanton të drejtën e jetës.

Përpos parashikimeve të sipërpërmendura në Bashkimin Evropian vepron Sistemi i Përbashkët i Azilit, i themeluar në Tampere të Finlandës si pasojë e konflikteve në Ballkan në vitet 1999-2004. Ky Sistem është i ndërtuar në bazë të një sërë rregulloresh dhe direktivash, të cilat janë pjesë e legjislacionit dytësor të Unionit.



Funksionimi i Sistemit të Përbashkët të Azilit në BE.

Direktiva mbi Procedurat e Azilit parashikon tërësinë e procedurave dhe dokumentave që një azilkërkues duhet të përbushë për të kërkuar azil. Kjo direktivë parashikon si do të procedohet me kërkesën e tij/saj, si mund të apelojë vendimin, si edhe kushtet specifike të intervistës për kërkesën për azil.

Direktiva e Kualifikimit përcakton kriteret se cilët persona do të konsiderohen azilkërkues ose persona të cilët po i shmangen një rreziku nga vendi i origjinës. Kjo direktivë ndihmon shtetet e BE-së për të harmonizuar mënyrën e përzgjedhjes së kërkesave për azil. Gjithashtu, parashtron një sërë parimesh si

ai i moskthimit, parimi i asistencës sociale, i të drejtës për integrim dhe akomodim në shoqërinë e shtetit anëtar etj.

Direktiva mbi Kushtet e Pritjes për Azilkërkuesit vendos kushtet minimale të trajtimit dhe të qendrave, të cilat presin dhe strehojnë azilantët. Gjithashtu, ajo përmban standarde për ndihmën mjekësore, ushqimin dhe mundësitë e punësimit për azilantët. Kjo Direktivë është miratuar në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut, specifkisht neneve referuese të KEDNJ-së.

Rregullorja EURODAC ka përcaktuar sistemin e identifikimit të azilkërkuesve, të cilët sapo hynë në vendin ku do të kërkojnë azil regjistrojnë shenjat e gishtërinjve në sistemin me të njëjtin emër.

Rregullorja Dublin III vendos rregulla mbi ekzaminimin e kërkesave për azil në shtetet anëtare të Unionit. Qëllimi i këtij legjisllacioni është të shmangë mbivendosjen e kërkesave, që bëhen nga të njëjtët azilantë në shtete të ndryshme të BE-së dhe në Islandë, Litenshtein, Finlandë, Zvicër dhe Norvegji, duke qartësuar se cili shtet do të ketë përgjegjësi për shqyrtimin e kërkesës. Kjo rregullore është paraprirë nga rregullorja Dublin I dhe Dublin II.

Në bazë të kësaj rregulloreje azilkërkuesit kanë mundësinë për të ankimuar vendimin për transferimin nga njëri prej vendeve nënshkruese të rregullores drejt vendit të parë në të cilin ai ka shkelur si azilkërkues.

Pas vendimit të Gjykatës së Strasburgut *M.S.S kundër Belgjikës dhe Greqisë* gjatë intervistës, që i nënshtrohen azilkërkuesit janë shtuar disa pyetje specifike lidhur me elementët relevantë, për të përcaktuar nëse klauzola e sovranitetit duhet

të zbatohet për të shmangur trajtimin e mundshëm çnjerëzor ose degradues të personit në fjalë, në rastin e transferimit në një shtet tjetër përgjegjës.

Pas vendimit të GJEDNJ-së *Tarakhel kundër Zvicrës*, autoritetet e vendeve nënshkruese të Rregullores Dublin duhet të ndërmarin masa parandaluese ndaj rrezikut, që mund të i kanoset shëndetit të një azilkërkuesi në rast transferimi në një vend tjetër përgjegjës për trajtimin e kërkesës së tij sipas rregullores.

Tre janë rastet kur konsiderohet se azilkërkuesi ka shkelur për herë të parë në një shtet të ndryshëm nga ai në të cilin po kërkon azil:

- » Personi ka kërkuar azil në atë shtet;
- » Është ligjërisht prezent, p.sh. zotëron Vizë të atij shteti;
- » Ka të regjistruara shenjat e gishtërinjve në sistemin EURODAC në atë shtet.

i Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut Neni 14 “Çdo njeri ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë të drejtën për azil në vende të tjera, në rast persekutimi, keqtrajtimi”.

ii Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian Neni 2 “Bashkimi ka në themel vlerat e respektimit të dinjitetit të njeriut, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave...” Neni 6 “1. Bashkimi njehtë drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, datë 7 dhjetor 2000, siç u përshtat në Strasburg , më 12 dhjetor 2007, e cila ka të njëjtën fuqi ligjore me Traktatet”.

ii Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian Neni 18 “E drejta për azil duhet të garantohet duke respektuar rregullat e Konventës së Gjenevës të 28 korrikut 1951 dhe Protokollit të 31 janarit 1967 në lidhje me statusin e refugjatëve dhe në përputhje me Traktatin Themelues të Komunitetit Evropian”.

IV. KUSH PËRFITON NGA STATUSI I AZILKËRKUESIT?

Statusin e refugjatit e përfitojnë të gjithë ata azilkërkues të cilët gjenden:

- a) përballë një gjendje frike të bazuar për shkak të:
 - » arsyeve racore;
 - » besimit;
 - » kombësisë;
 - » pjesëmarrjes në një grup shoqëror; apo
 - » opinionit të tyre politik.
- b) jashtë vendit të shtetësisë së tyre dhe e kanë të pamundur t`ja besojnë veten mbrojtjes së atij shteti;
- c) ose janë persona pashtetësi, që ndodhen jashtë ish-vendbanimit të tyre të zakonshëm dhe si rezultat i ndonjë ngjarje e kanë të pamundur të rikthehen në atë vend.

Megjithatë, çdo person që nuk i plotëson kushtet e dhënies së statusit të refugjatit dhe që jep prova se në vendin e tij është i ekspozuar ndaj kërcënimeve të rënda si:

- a) dënimi me vdekje;
- b) tortura ose dënimet a trajtimet çnjerëzore ose degraduese;
- c) është subjekt i një kërcënimi të rëndë, të drejtpërdrejtë ose individual kundër jetës ose vetes së tij për shkak të një dhune të përgjithësuar, *që gjeneron një situatë konflikti të armatosur të brendshëm ose ndërkombëtar, përfiton **statusin e mbrojtjes subsidiare.***

Përrjashtimi nga mbrojtja e refugjatëve

Individët përjashtohen nga statusi i refugjatit, në rastet kur në ngarkim tyre ka arsye serioze për të konsideruar se:

- a) kanë kryer një krim kundër paqes, një krim luftime apo një krim kundër njerëzimit;
- b) kanë kryer një krim të rëndë jashtë vendit të strehimit para pranimit të tij në vend si refugjat;
- c) janë deklaruar fajtor për akte në kundërshtim me qëllimet dhe parimet e Kombeve të Bashkuara.

A mundet që një person pa shtetësi të jetë dhe refugjat?

Pashtetësia nuk përbën persekutim nën përkufizimin e refugjatit të përcaktuar në Konventën për Refugjatit e vitit 1951, por ajo mund të jetë një element i persekutimit të marrë në mënyrë të përmbledhur me faktorë të tjerë. Heqja arbitrare e shtetësisë mbi baza diskriminuuese mund të krijojë shkaqe për një frikë të bazuar mbi persekutimin, veçanërisht kur rezulton në pashtetësi. Konventa e Gjenevës 1951 garanton të drejtat e refugjatëve, duke përfshirë dhe ata që janë pa shtetësi, ndërkohë që Konventa e vitit 1954 është projektuar për personat pa shtetësi, të cilët nuk janë refugjatë. Në rastet kur një person kulaifikohet për të dy statuset, prevalue e është Konventa e Refugjatit të vitit 1954.

V. TË DREJTAT DHE DETYRIMET QË DERIVOJNË NGA STATUSI I REFUGJATIT

Parimi i mosdiskriminimit kërkon që e drejta dhe politikat e shteteve nuk duhet të parashikojnë trajtim të ndryshëm ndaj migrantëve, duke kufizuar hapësirën e dallimeve që një shtet mund të bëjë midis shtetasve të vet dhe migrantëve. Shtetet duhet të japin një justifikim të pranueshëm për dallimet e parashikuara në aktet ligjore apo praktike.

Parimi i moskthimit i ndalon shtetet që të kthejnë mbrapa, të dëbojnë ose ekstradojnë një person të caktuar në territoret ose shtetet ku ka dyshime të bazuara se individit në fjalë i kërcënohet jeta ose liria, për shkak të racës, besimit, kombësisë, anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror ose për shkak të bindjeve të tij politike.



Personat që gëzojnë mbrojtje nga parimi i moskthimit janë:

- » Refugjatët - personat që kanë fituar statusin e refugjatit;
- » Azilkërkuesit - Personat që ende nuk e kanë fituar statusin e refugjatit, por që e pretendojnë një gjë të tillë në bazë të kritereve që ka vendosur vetë Konventa e vitit 1951.

Shtetet palë mund të mos zbatojnë parimin e moskthimit në këto dy raste

- » Janë persona për të cilët ka arsye të besohet se paraqesin rrezik për sigurinë publike dhe kombëtare të këtij shteti;
- » Janë dënuar për kryerjen e një krimi të rëndë jo-politik.

Të drejtat themelore të garantuara nga KEDNJ dhe instrumenta të tjera ndërkombëtare të detyrueshme për t`u respektuar nga çdo shtet për çdo azilkërkues apo refugjat janë:

- » **E drejta e jetës**
- » **Ndalimi i genocidit**
- » **Ndalimi i skllavërisë**
- » **Ndalimi i torturës, trajtimit çnjerëzor dhe degradues**
- » **Ndalimi i diskriminimit racial dhe sistematik**
- » **E drejta e vetëvendosjes**
- » **E drejta për trajtim njerëzor gjatë periudhës së ndalimit**
- » **Ndalimi i ndëshkimeve penale prapavepruese**
- » **E drejta e barazisë para ligjit**

Strehimi - Konventa e Gjenevës parashikon që Shtetet Palë duhet t'u akordojnë refugjatëve që qëndrojnë ligjërisht në shtetet e tyre, banesa me kushte sa më të përshtatshme të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më pak të favorshme se të huajt që gjenden në të njëjtën situatë.

Rastet e refugjatëve vulnerabël meritojnë trajtim të veçantë. Sipas Direktivës së Pritjes refugjatë dhe azilkërkues vulnerabël quhen personat e këtyre grupeve:

- » personat me aftësi të kufizuar;
- » të moshuarit;
- » prindër të vetëm;
- » gra shtatzëna;
- » të miturit;
- » viktimat të trafikimit.

Direktiva e Pritjes vë në dukje mundësinë për identifikimin e hershëm të nevojave të personave vulnerabël për të përgatitur procedurat e trajtimit të veçantë për ta kur janë në proces të vlerësimit të statusit të refugjatit.

VI. SI MUND TË MBROHEN AZILKËRKUESIT

Kërkesa për azil mund të paraqitet në pikat kufitare të një shteti duke përfshirë dhe aeroportin, ose në agjencitë *shtetërore për migracionin*. Sapo një azilkërkues paraqet një kërkesë për azil, autoritetet e pajisin atë me informacionin e nevojshëm mbi Rregulloren Dublin.

Pas paraqitjes së kërkesës, autoritetet duhet të vendosin nëse kërkesa duhet të refuzohet për shkak të konsiderimit vend i sigurt i origjinës apo përgjegjësinë e një shteti tjetër për shqyrtimin e kërkesës për azil.

Faza e parë e procedurës është procedura e pranueshmërisë dhe konsiston në vlerësimin nga ana e autoriteteve mbi pranueshmërinë e kërkesës.

Pas përfundimit të këtij shqyrtimi në fazën e dytë vlerësohet themeli nëse azilkërkuesit duhet t`i jepet statusi i refugjatit.

Në këtë moment mund të përballet me dy përgjigje të mundshme nga ana e autoriteteve:

- a. **Refuzim i kërkesës;**
- b. **Deklarim i kërkesës si haptazi e pabazuar.**

Azilkërkuesi mund të apelojë vendimin e shkallës së parë si për pranueshmërinë, ashtu edhe për themelin.

Efekti pezullues ndalon shtetin pritës të dëbojë azilkërkuesin. Ky efekt vepron kur azilkërkuesi ka ndërmarrë një apel kundër vendimit që shqyrton themelin e kërkesës. Ndërkohë që, apeli kundër një vendimi mbi papranueshmërinë e kërkesës nuk ka efekt pezullues dhe duhet të dorëzohet brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin e vendit pritës.

Rastet e mos lejimit të veprimit të efektit pezullues janë:

- » kur azilkërkuesi është përpjekur për të mashtruar mbi identitetin e tij të vërtetë, kombësinë apo vërtetësinë e dokumenteve të tij;
- » mungojnë arsyet për persekutim;
- » pabazueshmëria e pretendimeve të azilkërkuesit lidhur me rrezikun që do të përballet;
- » në rastet kur është lëshuar një urdhër dëbimi apo ndalimi për hyrjen e azilkërkuesit në shtetin pritës përpara paraqitjes së kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare.

Megjithatë, gjykatat mund të japin efekt pezullues në rast se ekziston rreziku për shkelje të parimit të moskthimit.

Së bashku me vendimin për refuzimin e kërkesës për përfitim e statusit të refugjatit lëshohet një urdhër dëbimi, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye, që lidhen me mundësinë e cenimit të së drejtës së jetës së qetë familjare dhe private sipas nenit 8 të KEDNJ-së, ku kjo e drejtë prevalon mbi rendin dhe interesin publik.

Azilkërkuesit mund të dërgojnë një ankim për marrjen e një mase të ndërmjetme në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e

SISTEMI I PËRBASHKËT I AZILIT TË BASHKIMIT EUROPIAN

AZILI u jepet personave të cilët u largohen persekutimit ose dëmeve serioze të jetës.

Procedura e aplikimit për azil është tashmë e ngjashme në të gjithë BE-në. (Direktiva mbi Procedurat e Aplikimit për Azil)

Shenjat e gishtërinjve të çdo aplikanti merren dhe regjistrohen në një sistem të dhënash që quhet EURODAC. Kjo ndihmon që të identifikohet shteti i cili është përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit për azil. (Sistemi i Dublinit)

Azilkërkuessit marrin të ardhura ose materiale gjatë kohës së qëndrimit në një shtet të caktuar, si psh. Ushqim dhe strehim. (Direktiva mbi Kushtet e Pritjes për Azilkërkuessit)

Azilkërkuessi merret në intervistë nga një punonjës i trajnuar mbi legjislacionin e BE-së, së bashku me një interpretues, në mënyrë që të përcaktohet nëse aplikanti mund të kualifikohet për marrjen e statusit të Azilkërkuessit dhe ndihmën shtesë. (Direktiva mbi Kualifikimin dhe Direktiva mbi Procedurat për Aplikimin për Azil)

Fillimisht statusi i refugjatit nuk i jepet aplikantit, por ky vendim mund të apelohehet në gjykatë.

Gjykatë konfirmon vendimin eparë për të mos i dhënë aplikantit statusin e refugjatit. Ai/ajo mund të kthehet në vendin e origjinës ose në një vend tjetër tranzit.

Gjykatë hedh poshtë vendimin negativ për të mos i dhënë statusin e refugjatit emigrantit.

Kur jepet statusi i refugjatit ose ndihma shtesë, ato i japin personit një sërë të drejtash si: e drejta për të aplikuar për leje qëndrimi, për të punuar apo për të përfutur nga sistemi shëndetsor. (Direktiva mbi Kualifikimin)

Procesi – Si mbrohet një azilkërkuess

Njeriut, në bazë të Rregullit 39 të Rregullores së Gjykatës dhe në zbatim të nenit 34 të KEDNJ-së.

Masat e ndërmjetme të GJEDNJ-së janë vendime urgjente, që zbatohen vetëm në rastet e ekzistencës së një rreziku të pashmangshëm, pasojat e të cilit nuk mund të ndreqen.

Gjykata e Strasburgut vlerëson nëse ekzistojnë arsye të bazuara se azilkërkuesit i rrezikohet jeta, ose do të jetë subjekt i një keqtrajtimi në rast kthimi në vendin e origjinës, të drejta këto të garantuara nga nenet 2 dhe 3 i KEDNJ-së. Pranueshmëria ose jo e masave të ndërmjetme nuk apeloher. Megjithatë, këto masa nuk kanë ndikim mbi vendimin përfundimtar të GJEDNJ-së për çështjet në fjalë. Masat e ndërmjetme kanë fuqi deri në përfundim të procesit gjyqësor pranë Gjykatës së Strasburgut. Për rrjedhojë, azilkërkuesit nuk mund të deportohen deri në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor.

BIBLIOGRAFI

Legjislacion ndërkombëtar

Konventa e Gjenevës 1951 dhe Protokollin e 1967 në lidhje me Statusin e Refugjatit.

Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian.

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian.

Qualification Directive 2011/95/EU.

Reception Conditions Directive 2013/33/EU.

The Asylum Procedures Directive 2013/32/EU.

Dublin III Regulation 604/2013.

Literaturë

Balla H., & Hereni M., & Pipero A., & Dyduch, X. (2015). Sfidat e Integritetit të Refugjatëve në Shqipëri. Tiranë: UNCHR.

Bianku, L. (2007). Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut. Tiranë: Qendra Evropiane.

Bianku, L. (2012, Volume I). Cyprus Human Rights Law Review "For whom the alarm bells ring". Cambridge: European Human Rights Law Institute.

European Union Agency for Fundamental Rights & Council of Europe. (2014). Handbook on European Law relating to asylum, borders and immigration. Strasbourg: Council of Europe.

<http://www.unhcr.org/refworld/docid/3f93aede7.html> (konsultuar më 25.02.2016).

Ikononi, L. (2009). E drejta migratore. Tiranë: IOM.

Ministria e Punëve të Brendshme, Sekretariati i Përgjithshëm për Migrim dhe Integrim. (2011). Udhëzues për Azilkërkues. Francë: Paris.

Mucaj, A. R. (2006). Përmbledhje e instrumenteve ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm për policinë kufitare dhe të migracionit që merret me të huajt e parregullt. Tiranë: CARDS.

United Nations High Commissioner for Refugees. (...). Broshurë informuese në lidhje me pashtetësinë. Tiranë: UNHCR.

United Nations High Commissioner for Refugees. (2011). UNHCR Resettlement Handbook. Geneva: UNHCR.

United Nations High Commissioner for Refugees. General Conclusion on International Protection, 10 October 2003, No. 95 (LIV) - 2003,

Zemani, A. et. al. (2006). Manual për rojet e policisë kufitare dhe migracionit mbi atributet gjyqësore dhe përzgjedhjen e të huajve. Tiranë: CARDS.



Qendra Europiane

Rr. Vaso Pasha

P. 20, Ap. 57

Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 451 9076

www.euro-centre.eu



**Konrad
Adenauer
Stiftung**

Fondacioni Konrad Adenauer

Blv. Dëshmorët e Kombit

Kulla Binjake 1, K. 11, Ap. 3

Tiranë, Shqipëri

Tel: + 355 4 22 66525

www.kas.de/albanien